



Pranuar / Doretuar Pitiljenoi/Prodato Received/Delivery	20. 11 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	7035/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1188/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1188/2023 të datës 20.09.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.1188/2023 e datës 20.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

Ankuesi është i punësuar sipas Kontratës së Punës të datës 01.07.2018 në pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Korrektuesë në Dubravë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Me datën 20.09.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6173/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër heshtjes administrative si dhe lidhur me mos zbatimin e vendimit në cilësinë e Mbikëqyrësit Korrektues dhe kompensimin e pagave nga data emërimit nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës, siç pretendon ankuesi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 02.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 02.11.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6173/2023 të datës 20.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga D.R. për A.D. i datës 20.12.2022; E-mail nga D.R. për A.D. i datës 15.05.2023; Certifikatë nga Unmik për D.R. i datës 21.02.2002; Certifikatë nga Unmik për D.R. e muajit Qershor 2003; Certifikatë për D.R. e muajit Nëntor 2005; Pliko me numër R5408698 i datës 18.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 02.10.2023; Shkresat e lëndës me numër protokoll 1219 i datës 29.09.2023; Kontratë Pune për pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Korrektuese në Dubravë në Shërbimin Korrektues të Kosovës e D.R. i datës 01.07.2018; Rekomandim për përtëritjen e kontratës e D.R. i datës 15.05.2018; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 03.01.2020; Shkresë Qendra e trajnimit në burgun e Dubravës e datës 19.02.2004; Përshkrimi i punës së trajnerit të qendrës shkk; Listë me emra të pjesëmarrësve e muajit shkurt 2004; Mirënjohje nga Shërbimi Korrektues i Kosovës Qendra Korrektuese Dubravë për D.R. i datës 29.12.2017; E-mail nga D.R. për A.D. i datës 15.05.2023; Lista e pagave Janar-Gusht 2023; Certifikatë nga MPB Qendra e Kosovës për siguri publike, edukim dhe zhvillim për D.R. i datës 18.09.2009; Certifikatë nga Unmik për D.R. e vitit 2004-2005; Certifikatë trajnimi nga CLR disturbance control për D.R. i datës 06.05.2005; E-mail nga A.K. për A.H. etj. i datës 27.09.2023; E-mail nga K.S. për C.Z. i datës 03.10.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 1225 i datës 02.10.2023; E-mail nga A.D. për D.R. i datës 02.10.2023; E-mail nga A.D. për K.S. i datës 20.03.2023; E-mail nga A.D. për K.S. i datës 20.12.2022; E-mail nga D.R. për A.D. i datës 20.12.2022; Vendim me numër protokoll 6839/2023 i datës 02.11.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës ankuesi është i punësuar sipas Kontratës së Punës të datës 01.07.2018 në pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Korrektuese në Dubravë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. I njëjti me datë 15.05.2023 ka bërë kërkesë tek Menaxheri i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës ku nga i njëjti ka kërkuar kopjen e konkursit për Mbikëqyrës të vitit 2005, ndërsa i njëjti nuk i ka kthyer përgjigje. Kolegji i Këshillit ka konstatuar se, bazuar në përgjigjen e pranuar të datës 02.10.2023 nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës është njoftuar se nuk kemi konkurs të publikuar lidhur me pretendimet e palës dhe ky konkurs nuk gjendet në dosjen e tij dhe as në Qendrën Korrektuese në Dubravë, dhe se vendimi për emërim në cilësinë e Mbikëqyrësit ju njoftojmë se lidhur me këtë Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk e ka poseduar këtë vendim dhe në dosjen e ankuesit nuk ekziston ky vendim.

Ankuesi me datë 20.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore kundër heshtjes administrative si dhe lidhur me mos zbatimin e vendimit në cilësinë e Mbikëqyrësit Korrektues dhe kompensimin e pagave nga data emërimit nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës.


Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstaton se sipas nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*, si rrjedhojë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar lidhur me pretendimet ankimore kundër heshtjes administrative si dhe lidhur me mos zbatimin e vendimit në cilësinë e Mbikëqyrësit Korrektues dhe kompensimin e pagave nga data emërimit nga ana e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, si rrjedhojë meqenëse ankuesi me datë 15.05.2023 ka bërë kërkesë lidhur për kopjen e konkursit për Mbikëqyrës të vitit 2005, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 20.09.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1188/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

